



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR

**PËRMBYLLJEN E PROCESIT TË MBIKËQYRJES SË LIGJSHMËRISË NË
APLIKIMIN E INSTITUTIT TË PËRFUNDIMIT TË MARRËDHËNIES NË
SHËRBIMIN CIVIL PËR SHKAK TË LIGJIT, NË INSTITUCIONIN E VARËSISË TË
MINISTRISË SË ARSIMIT**

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Tiranë, Mars 2026

RAPORT

Për përmbylljen e mbikëqyrjes së ligjshmërisë në aplikimin e institutit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit parashikuar në nenin 65, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar në institucionin e varësisë të Ministrisë së Arsimit Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

HYRJE

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe të urdhrit nr. 82, datë 31.12.2025, “Për miratimin e planit vjetor të punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2026”, ka filluar mbikëqyrjen me objekt verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në aplikimin e institutit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, parashikuar në nenin 65, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit në varësi të Ministrisë së Arsimit.

Gjatë këtij procesi, janë vlerësuar veprimet administrative të kryera nga njëësia e burimeve njerëzore dhe Departamenti i Administratës Publike, me cilësinë e njësisë përgjegjëse, në përputhje me gërmen f, neni 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si organe të ngarkuara nga ligji me detyra specifike, gjatë zbatimit të procedurave për aplikimin e institutit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.

Mënyra e funksionimit të institucionit të mbikëqyrur rregullohet nëpërmjet VKM-së, nr. 607, datë 31.08.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e AKKSHI” dhe misioni i tij është të nxisë kërkimin shkencor dhe inovacionin nëpërmjet mbështetjes, monitorimit e vlerësimit të programeve dhe projekteve në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit, si dhe administrimin e përditësimit e bazës kombëtare të të dhënave për kërkimin shkencor dhe inovacionin.

Struktura dhe organika e këtij institucioni, miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Institucioni përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil e për pasojë, marrëdhëniet e punës për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit që kryejnë detyra në pozicione të shërbimit civil, rregullohen sipas këtij ligji, ndërkohë që marrëdhëniet e punës për punonjësit administrativë, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Në zbatim të urdhrit nr. 38, datë 17.02.2026, “Për fillimin e mbikëqyrjes me objekt verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në aplikimin e institutit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, në institucionet në varësi të Ministrisë së Arsimit, për vitin 2025”, të Komisionerit administrimi i të dhënave dhe dokumentacionit në subjekt u realizua sipas Programit të Mbikëqyrjes nr. 333/1 prot., datë 17.02.2026, i cili i është njoftuar institucionit me shkresën nr. 333/4 prot., datë 17.2.2026, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në

administrimin e shërbimit civil, në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit”. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes në datën 23.2.2026.

Grupi i punës, i përbërë nga inspektorët *Inesa Çani dhe Have Brahollari*, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes *Altin Shumeli*, administroi aktet përkatëse, pranë AKKSHI-it (*procesverbali i datës 23.2.2026*) si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike (*procesverbali i datës 18.3.2026*) dhe pas përpunimit dhe analizës së tyre është përgatitur raporti i mbikëqyrjes.

QËLLIMI I MBIKËQYRJES:

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Zbatimi i ligjshmërisë në aplikimin e institutit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, parashikuar nga neni 65, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- Paraqitja para personave përgjegjës për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore, njësisë përgjegjëse dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

DREJTIMET E MBIKËQYRJES:

Mbikëqyrja është orientuar drejt verifikimit të situatës së administrimit të shërbimit civil në këtë institucion, për të arritur në konkluzion se si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me respektimin e skemës së administrimit të shërbimit civil, si dhe të procedurave që ndiqen gjatë aplikimit të instituteve të ligjit, duke u fokusuar konkretisht:

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të institutit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, në institucionet e varësisë të Ministrisë së Arsimit, për vitin 2025.
2. Verifikimi i procedurave të ndjekura nga njësitë e burimeve njerëzore si dhe njësia përgjegjëse (DAP), lidhur me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil përkatësisht për këto raste:
 - kur nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
 - kur plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;
 - kur konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;
 - kur dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

- kur nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij.
3. Respektimi i afateve procedurale lidhur me njohjen apo ndodhjen e shkakut si dhe veprimet administrative të cilat kryehen nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën apo Departamentit të Administratës Publike për anëtarët e TND-së.
 4. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë aplikimit të nenit 65 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Aneks i Programit: Aktet administrative që janë vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes janë:

1. Struktura organizative e institucionit.
2. Listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve të institucionit për muajin dhjetor 2025.
3. Plani vjetor i pranimit për institucionin që do të mbikëqyret në raport me rastet e lidhura me pikën 2, seksioni: “Drejtimit e mbikëqyrjes”.
4. Akti i konstatimit të plotësisë së kushtit sipas përcaktimeve të nenit 65, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe akte të tjera që materializojnë institutin e ligjit objekt mbikëqyrje.
5. Akte të tjera të cilat do të konsiderohen të nevojshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të mbikëqyrjes.

METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES:

Objekti i mbikëqyrjes përfshin verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në aplikimin e institutit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, parashikuar në nenin 65, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin e varësisë së Ministrisë së Arsimit, Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), për vitin 2025.

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin në vend të të gjitha akteve administrative të përmendura më sipër, si dhe të çdo dokumenti tjetër të domosdoshëm për realizimin e objektit të mbikëqyrjes.

Ky dokumentacion administrohet në arkivin e institucionit, si dhe në Sektorin e Burimeve Njerëzore.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, fillimisht u realizua një takim me përfaqësuesin e institucionit AKKSHI-së, Përgjegjësen e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, zj. Adivije Luca, gjatë të cilit u diskutua mbi qëllimin, programin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord lidhur me dokumentacionin shkresor që duhej t’i vihej në dispozicion grupit të mbikëqyrjes për verifikim.

Në kuadër të këtij procesi, u mbajt procesverbal në institucionin e Ministrisë së Arsimit, me përfaqësuesin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, z. Novruz Ahmeti, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike, me znj. Eva Ramaj.

Këto akte administrohen në dosjen përkatëse të mbikëqyrjes që është ushtruar në këtë institucion.

PËRMBAJTJA E RAPORTIT:

I. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes.

Institucioni i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, si person juridik publik, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi në nenin 2 të tij, përcaktohet se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore.

Mënyra e funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, është e rregulluar me VKM-në nr. 607, datë 31.8.2016, “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e AKKSHI”, ndërsa struktura dhe organika janë miratuar me Urdhrin nr. 48, datë 12.04.2017 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit”, të ndryshuar me urdhërin nr.158, datë 5.10.2023, të Kryeministrit.

Bazuar në strukturën dhe organikën në fuqi në momentin e mbikëqyrjes, institucioni ka gjithsej **19** pozicione pune, nga të cilat **18** i përkasin shërbimit civil dhe **1** pozicion pune është funksion administrativ. Në momentin e verifikimit të situatës në subjekt, rezulton se **17** pozicione janë të plotësuara, ndërsa **1** pozicion është vakant.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, situata paraqitet si më poshtë:

- Nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese - 1 pozicion pune, i cili i përket pozicionit “Drejtor i Përgjithshëm” (një pozicion vakant);
- Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese - 2 pozicione pune, të cili i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”;
- Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese -5 pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori”;
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive – 10 pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Specialist” (një pozicion vakant).

Në formë tabelare, ndarja e pozicioneve të punës në këtë institucion në raport me mënyrën e rregullimit të marrëdhënies së punës, si edhe në raport me klasifikimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, paraqitet e tillë:

Tabela nr. 1. Organizimi i burimeve njerëzore në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Institucioni i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	Pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil				Funksione politike ose administrative
	Kategori e lartë drejtuese	Kategoria e mesme drejtuese	Kategoria e ulët drejtuese	Kategoria ekzekutive	Punonjës Administrativ
Numri total i pozicioneve të punës sipas strukturës së miratuar	1	2	5	10	1
Totali 19	18				1

Konstatim: Në strukturën organizative të institucionit të mbikëqyrur evidentohen qartë pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil.

II. Verifikimi i procedurave të ndjekura nga njësia e burimeve njerëzore si dhe njësia përgjegjëse (DAP), lidhur me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.

Në lidhje me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, në përmbajtjen e nenit 65, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, evidentohen në mënyrë të shprehur rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, si edhe afati dhe organi që konstaton rrethanat, si më poshtë:

1. Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon për shkak të ligjit kur:

- nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij;
- nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
- plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;
- konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;
- dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, konstatohet 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij nga:

- njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën;
- DAP-i për anëtarët e TND-së.

Në kuadër të përmbushjes së objektit të mbikëqyrjes, Komisioneri administroi dokumentacionin në subjekt si edhe verifikoi të dhënat pranë Ministrisë së Arsimit, si institucioni në varësi të të cilit është AKKSHI, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike, me cilësinë e Njesisë Përgjegjëse, në kuptim të germës “f”, të nenit 4, Kreu I, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Sipas procesverbalit të mbajtur në subjekt në datën 23.2.2026, *“Procesverbal për administrimin dhe verifikimin e dosjeve të personelit”*, grupi i punës, administroi aktet si më poshtë:

- Urdhëri nr. 158, datë 5.10.2023, “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 48 datë 12.4.2017” të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit”, i Kryeministrit;
 - Vendimi nr. 607, datë 31.8.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e AKKSHI”, i Kryeministrit;
 - Vendimi nr. 464, datë 31.7.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, Për krijimin, përbërjen organizimin dhe funksionimin e AKKSHI”, i Kryeministrit;
 - Listë prezenca e muajit dhjetor 2025;
 - Listë pagesa e muajit dhjetor 2025;
 - Vendimi nr. 1312/1 Prot, datë 6.3.2026 “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit”, për znj. Mirela Muça, i Departamentit të Administratës Publike.
 - Fotokopje të Regjistrisë Qendror të Personelit, me të dhënat e gjeneraliteteve dhe datëlindjet e nëpunësve.
- Pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Arsimit, u mbajt procesverbali i datës 10.3.2026, në të cilin u administrua shkresa drejtuar DAP, me nr. 7272/1 prot., datë 10.12.2024 “Mbi planifikimin e nevojave për pranim në shërbimin civil për vitin 2025”.
 - Pranë Departamentit të Administratës Publike, u mbajt procesverbali i datës 18.3.2026, në të cilin u administruan praktikantët dhe dokumentacioni përkatës i verifikuar gjatë procesit të mbikëqyrjes.

Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, për të gjitha rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të parashikuara në pikën 1, të nenit 65, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nisur nga analiza e dokumentacionit të administruar dhe pas komunikimit me përfaqësuesit e institucionit të AKKSHI; Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Arsimit dhe të Departamentit të Administratës Publike, situata në raport me të gjitha paragrafët që e përbëjnë këtë dispozitë, paraqitet e tillë:

- a) “nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarin e vdekjes së tij”: rezulton se **nuk ka** asnjë rast të evidentuar që lidhet me aplikimin e kësaj pike;
- b) “nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar”: rezulton se **nuk ka** asnjë rast të evidentuar që lidhet me aplikimin e kësaj pike;
- c) “plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë”: rezulton se **ka një** rast të evidentuar që lidhet me aplikimin e kësaj pike dhe bëhet fjalë për punonjësen Mirela Muça, anëtare e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND), me detyrë “Drejtor i Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit”, e cila ka ndërprerë marrëdhënien me institucionin me aktin nr. 1312/1 prot, datë 6.3.2026, të Departamentit të Administratës Publike (DAP) në cilësinë e njësisë përgjegjëse.

Nga verifikimi i këtij rasti ka rezultuar se janë respektuar kriteret dhe procedura e parashikuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil.

Duke verifikuar dokumentin e identifikimit ka rezultuar se punonjësja ka përmbushur kriterin e moshës për të dalë të pension të plotë pleqërie.

Nga ana tjetër, në kushtet kur punonjësja ka qenë anëtare e TND-së, deklarimi i përfundimit të marrëdhënies me shërbimin civil është kryer nga Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet një akti administrativ i cili i është njoftuar palëve.

- c) “konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit”: rezulton se **nuk ka** asnjë rast të evidentuar që lidhet me aplikimin e kësaj pike;
- d) “dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale”: rezulton se **nuk ka** asnjë rast të evidentuar që lidhet me aplikimin e kësaj pike.

Konkluzion: Për sa i përket përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, në zbatim të nenit 65 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nga analiza e të dhënave të administruara gjatë procesit të mbikëqyrjes në subjekt për periudhën Janar-Dhjetor 2025, si dhe nga informacioni i marrë nga njësia përgjegjëse Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Arsimit, rezulton se **ka** një rast, të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil sipas dispozitës në fjalë.

Në këto rrethana është nxjerrë akti përkatës nga Departamenti i Administratës Publike, në përputhje me kërkesat e ligjit.

*
* *

Këto ishin rrethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse (DAP) dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes në institucionin e AKKSHI, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar si më poshtë:

Aneksi 1 “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punojnë në pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin e AKKSHI*”

Aneksi 2 “*Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin e AKKSHI*”.

Këto akte dhe tabela i bashkëlidhen raportit, si pjesë e tij.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)